



Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian

Çfarë dokumentacioni duhet të paraqes për të përfituar nga këto shërbime?

- Fotokopje të kartës së identitetit apo pasaportës
- Certifikatë familjare
- Një dokument që vërteton statusin e punësimit / papunësisë
- Një dokument që vërteton çdo pagesë që ju mund të jeni përfitues nga skema shtetërore e mbështetjes shoqërore (ndihmë ekonomike, pagesë për aftësinë e kufizuar, etj.)
- Çdo dokument tjetër i nevojshëm në varësi të rastit të paraqitur si përfitues i mundshëm nga ky projekt.

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit "Modeli i Qëndrueshëm për Shërbimet e Integruara të Punësimit dhe Kujdesit Social në Bashkinë e Mallakastrës", bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, koordinuar nga Bashkia Mallakastër në partneritet me Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Misioni në Shqipëri dhe Qendra Sociale Murialdo.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Qendra Komunitare Shumëfunktionale Ballsh

Lagja 5 Shkurti, Rr. Zenel Hekali,
Ndërtesa nr. 51 Hyrja 1
Kod postar 9308

**SHËRBIMET E PUNËSIMIT
NË QENDRËN
KOMUNITARE
SHUMËFUNKSIONALE BALLSH**



EJA DHE TI NË QKSHF BALLSH!

QKSHF Ballsh është një qendër bashkëkohore me mjedise funksionale dhe staf profesional e vënë në funksion të projektit 'Modeli i Qëndrueshëm i shërbimeve të integruara të punësimit dhe kujdesit shoqëror në Bashkinë e Mallakastrës'.

Projekti synon të kontribuojë në përfshirjen shoqërore të grupeve të rrezikuara (Gratë dhe të Rinjtë) në Bashkinë Mallakastër nëpërmjet punësimit dhe kujdesit shoqëror.

Të gjitha shërbimet që ofrohen në Qendrën Komunitare Shumëfunksionale Ballsh për përfituesit janë pa pagesë.

SHËRBIMET NË QKSHF BALLSH

- **Orientim dhe këshillim profesional për zhvillim karriere** - orientim, mbështetje dhe këshillim për të rinjtë në nevojë mbi edukimin dhe mundësitë e zhvillimit të karrierës profesionale.
- **Zhvillimi dhe fuqizimi i aftësive me fokus formimin profesional** - Mbështetje për të zhvilluar aftësitë dhe kualifikimet profesionale (Kurse të formimit profesional).
- **Mbështetje dhe ndërmjetësim për punësim** - Regjistrim në zyrat e punës si punëkërkues, orientim dhe mbështetje për kërkim të vendeve të punës, trajnime për rritjen e aftësimit për punësim
- **Formim profesional në vendin e punës** - të punosh dhe të trajnohesh në vendin e punës.



PËR KË ËSHTË KY SHËRBIM?

Shërbimet e mbështetjes së punësimit ofrohen për të gjithë të rinjtë dhe gratë në situatë të vështirë në Bashkinë Mallakastër.

SI MUND TË PËRFITOJ DHE UNË?

Kriteret kryesore të përzgjedhjes së përfituesve të QKSHF Ballsh janë si më poshtë:

- **Vendbanimi** - Të gjithë përfituesit duhet të jenë banorë të bashkisë Mallakastër.
- **Situata ekonomiko - shoqërore** - përcaktohen si përfitues kryesorë dhe kanë prioritet ata përfitues që janë në vështirësi ekonomike dhe që jetojnë nën ose në nivelin e varfërisë.
- **Mosha** - Përfituesit duhet t'i përkasin grupmoshës 15-45 vjeç (gra dhe të rinj).

Do të konsiderohen edhe ato faktorë të tjerë që sipas rastit të përfituesit e bëjnë këtë përfitues në situatë të vështirë nga ana shoqërore dhe ekonomike si:

- niveli i ulët i të ardhurave
- statusi i punësimit (i përhershëm, sezonal, ditor)
- vetë individi apo familjarë me aftësi të kufizuara
- të rinj kryefamiljarë- nëna kryefamiljare

